

Udhëzime të shkurtëra

për inicijimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të këshillit të ndërmarrjes

Në ndërmarrjen e punës nuk ekziston ende një Këshill i ndërmarrjes, i cili në rast nevojë do të përfaqësojë me atë rast interesat e të punësuarve. Tani është për tu zgjedhur një Këshill i ndërmarrjes. Këto udhëzime të shkurtëra ju japin një pasqyrë të parë në lidhje me atë, se **në cilat prej ndërmarrjeve të punës** është i mundur të realizohet një zgjedhje e një Këshilli të ndërmarrjes dhe **në cilën mënyrë do të zhvillohet procedura e zgjedhjeve** të tilla. Informacione të hollësishme mund të gjeni në udhëzuesit e zgjedhjeve për procesin zgjedhor normal dhe atë të thjeshtëzuar. Këto përmbajnë në mënyrë plotësuese, gjithashtu edhe një numër të teksteve shembull dhe listat e kontrollit, të cilat lehtësojnë zbatimin e procedurës së zgjedhjeve të Këshillit të ndërmarrjes.

1. Ku mund të zgjidhet një Këshill i ndërmarrjes?

Ligji kushtetues mbi ndërmarrjet e punës parashikon krijimin e Këshillave të ndërmarrjeve, **në ndërmarrjet** e punës, në të cilat janë të punësuar të paktën **pesë punëmarrës/e me kontratë të përhershme dhe me të drejtë për tu votuar. Tre** prej tyre duhet të kenë **të drejtë votimi**.

Ndërmarrjet e punës janë për tu dalluar nga kompanitë. Një kompani (p.sh. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose një shoqëri aksionare) mund të ketë një ose më shumë ndërmarrje. Pra me anë të kësaj, në një kompani mund të ketë disa Këshilla ndërmarrjesh, të cilat pastaj dërgojnë anëtarë në një Këshill të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Një ndërmarrje është një përmbledhje e të punësuarve dhe teknikës, të cilët sa i përket organizimit të tyre dirigojnë nga një sistem i vetëm menaxhimi. Ky aparat menaxhues duhet të ketë kompetencat vendim-marrëse thelbësore në çështjet personale (punësimin, transferimin në vend tjetër pune, ndërprerjen e marrëdhënies së punës) si dhe në çështjet sociale (rendi, orari i punës, planifikimi i pushimeve, etj.).

Me të drejtë aktive votimi janë të gjithë punëmarrësit/punëmarreset, pavarësisht nga kombësia e tyre, të cilët janë të punësuar në atë ndërmarrje pune dhe të cilët deri në ditën e zgjedhjeve kanë mbushur moshën 18 vjeçare. Ndër votuesit me të drejtë vote janë gjithashtu punëmarrësit/punëmarreset me kohë të pjesëshme pune.

Punëmarrësit/punëmarreset në huazim kanë të drejtë të votojnë, nëse janë të punësuar në atë ndërmarrje pune për më shumë se tre muaj ose nëse është planifikuar një angazhim i tillë i tyre me të njëjtën kohëzgjatje pune. Të punësuarit e Udhëheqësisë të cilët kryejnë detyra sipërmarrëse, nuk kanë të drejtë vote.

Të gjithë punëmarrësit/punëmarreset, të cilët janë me të drejtë aktive votimi dhe të cilët i takojnë të njëjtës ndërmarrje për të paktën gjashtë muaj, pavarësisht nga kombësia e tyre, kanë **të drejtë për tu votuar**. Periudhët e punësimit në ndonjë ndërmarrje tjetër të së njëjtës kompani ose në një

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschk - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.

kompani tjetër të korporates së kompanive do të llogariten gjithashtu.

2. Si zhvillohen zgjedhjet e Këshillit të ndërmarrjes?

Zgjedhjet e Këshillit të ndërmarrjes pregaditen dhe zhvillohen gjithnjë nga ana e një **bordi zgjedhor**. Nëse kemi të bëjmë me faktin që veqse ekziston një Këshill i ndërmarrjes, atëher i njeiti edhe emëron bordin zgjedhor. Nëse ende nuk ekziston një Këshill i ndërmarrjes, atëher bordi zgjedhor mund të emërohet nga ana e Këshillit të përgjithshëm të ndërmarrjeve ose nga ana e Këshillit të ndërmarrjeve të korporatës. Nëse nuk ekziston një Këshill i përgjithshëm i ndërmarrjeve dhe/ose nëse nuk ekziston një Këshill i ndërmarrjeve të korporatës, apo nëse i njeiti nuk bëhet aktiv, atëher në atë rast bordi zgjedhor në një ndërmarrje pa përberje të Këshillit të ndërmarrjes zgjidhet në një Mbledhje të ndërmarrjes nga pjesa dërmuese e të punësuarve të cilët janë të pranishëm. Nëse dështon emërtimi i bordit zgjedhor gjatë Mbledhjes së ndërmarrjes, atëher tre punëmarrës/punëmarrëse me të drejtë vote apo një sindikat pune e cila përfaqsohet në atë ndërmarrje mund të parashtrojnë pranë Gjykatës së Punës një kërkesë për emërtimin e një bordi zgjedhor.

Mënyra e procesit zgjedhor dhe hapat individual të nevojshëm me atë rast mvaren nga ajo, se sa punëmarrës/punëmarrëse me të drejtë votimi janë të punësuar në një ndërmarrje pune. Nëse për zakonisht në një ndërmarrje pune janë të punësuar **në mes 5 dhe 50 punëmarrës/e me të drejtë votimi**, atëher zbatohet **procedura e thjeshtëzuar zgjedhore**.

Nëse në atë ndërmarrje të punës janë të punësuar **më shumë se 50 punëmarrës/e me të drejtë vote**, për zakonisht aplikohet procedura normale zgjedhore. Në ndërmarrjet e punës me 51 deri në 100 punëmarrës/e me të drejtë vote, ekziston mundësia që bordi zgjedhor të pajtohet me punëdhënësin për të zbatuar procedurën e thjeshtëzuar zgjedhore. Nëse janë të punësuar më shumë se 100 punëmarrës/punëmarrëse me të drejtë vote, zbatohet vetëm **procedura normale zgjedhore**.

Procedura zgjedhore e thjeshtëzuar shpjegohet më gjërësisht në vazhdim e sipër nën pikën 2.1.

Procedura zgjedhore normale shpjegohet më gjërësisht në vazhdim e sipër nën pikën 2.2.

2.1 Rrjedhimi i procedurës së thjeshtëzuar zgjedhore

Sa i përket **procedurës së thjeshtëzuar zgjedhore** janë për tu dalluar **dy variante** të ndryshme: procedura njëfazëshe dhe procedura dyfazëshe. Procedura dyfazëshe (2.1.1.) gjenë zbatim, në qoftë se ende nuk ekziston një Këshill i ndërmarrjes dhe në qoftë se bordi zgjedhor zgjidhet përgjat Mbledhjes së ndërmarrjes së punës. Procedura njëfazëshe (2.1.2) gjenë zbatim, në qoftë se bordi zgjedhor emërohet nga ana e një këshilli të ndërmarrjes i cili veqse ekziston ose nga ana e një këshilli të përgjithshëm të ndërmarrjeve- ose të korporatës.

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschek - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.

2.1.1. **Procedura dyfazëshe:** Nëse është për tu zgjedhur bordi zgjedhor në një Mbledhje të ndërmarrjes së punës, atëher do të mbahen **dy Mbledhje zgjedhore**. Përgjat **Mbledhjes së parë zgjedhore** do të zgjedhen nga ana e të punësuarve anëtarët e bordit zgjedhor si dhe Udhëheqësi i bordit zgjedhor. Në atë Mbledhje të parë zgjedhore mund të ftojnë tre punëmarrës/e me të drejtë votimi ose një sindikat e punës e cila është e përfaqësuar në atë ndërmarrje pune.

Përgjat ftesave të tilla janë për tu marrur patjetër në konsiderat disa formalitete të veçanta. Përgjat Mbledhjes së parë zgjedhore bordi zgjedhor përpilon një liste votimi, në të cilën janë për tu shenuar ndaras sipas gjinisë së tyre të gjithë punëmarrësit/punëmarrëset me të drejtë vote. Dokumentacionet e nevojshme për një gjë të tillë bordi zgjedhor do ti pranon të dorzuar nga ana e atyre të cilët kanë ftuar për Mbledhjen e zgjedhjeve, e të cilët të njezat dokumentacione i kanë kërkuar më parë tek Punëdhënësi. Më pas bordi zgjedhor do të lëshon një listë për shpalljen e zgjedhjeve. Shpallja e zgjedhjeve përmban shumë informacione të rëndësishme për votuesit/votueset. Vendet minimale për gjinin në pakicë janë për tu marrur në konsiderat. Kandidatët/kandidatet për zgjedhje do të propozohen me atë rast qysh se përgjat Mbledhjes së parë të zgjedhjeve. Një propozim zgjedhje mund të emërtoj një ose më shumë kandidat/e. I njejtë përbëhet nga një deklaratë pëlqimi e kandidatit/kandidates dhe deklaratat mbështetëse të 3 të punësuarve (nëse kemi të bëjmë me faktin e deri në 20 të punësuarve me të drejtë vote, atëher mjaftojnë vetëm 2 deklarata mbështetëse). Propozimi për zgjedhje mund të dorëzohet me shkrimë ose të jipet gojarisht.

Një javë pas Mbledhjes së parë të zgjedhjeve vjen deri tek **Mbledhja e dytë e zgjedhjeve për zgjedhjen e Këshillit të ndërmarrjes**. Këshilli i ndërmarrjes do të votohet në zgjedhje sekrete dhe të drejtëpërdrejta. Bordi i zgjedhjeve do të ju shpërndajë me atë rast të punësuarve me të drejtë vote një fletë votimi dhe një zarf të votimit. Në atë fletë votimi janë të radhitur kandiduesit/kandidueset në rënditje alfabetike. I punësuarit me të drejtë vote mund të plotësoj aq shumë kandidues/e, sa edhe janë për tu ndarë vende për to. Pas plotësimit të kandiduesve/kandidueseve fletëvotimi do të futet në zarfin e votimit dhe do të hudhet në kutin e zgjedhjeve. Nëse ditën e votimit punëmarrësit/punëmarrëset nuk janë prezent, atyre është për të ju ofruar mundësia e dorzimit të votës se tyre me shkrimë (votimi me anë të letrës). Punëmarrësit/punëmarrëset kanë të drejtë të parashtrorjnë kërkesë deri në tre ditë para Mbledhjes së dytë të zgjedhjeve për dorzimin e votës se tyre me shkrimë. Numërimi i votova bëhet në mënyrë publike në vazhdim e sipër pas Mbledhjes së zgjedhjeve ose - me sa edhe është parashtruar kërkesë për dorzimin e votës në mënyrë të mëpasme me shkrimë - në një moment tjetër kohe, i cili është komunikuar më parë nga ana e bordit zgjedhor. Kandidatët/kandidatet të cilët arrijnë të mbledhin shumicën e votave në anën e tyre, janë të zgjedhurit. Gjinia në pakicë është për tu marrur në konsiderat të duhur përgjat ndarjes së vendeve. Kandidatët/kandidatet e zgjedhur me atë rast janë për tu informuar menjëher pas zgjedhjes së tyre.

2.1.2 **Procedura njëfazëshe:** Nëse është bërë emërtimi i bordit zgjedhor nga ana e Këshillit të

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschk - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.

ndërmarrjes i cili veqse ekziston, nga ana e Këshillit të përgjithshëm të ndërmarrjeve ose të Këshillit të ndërmarrjeve të korporates, i njeiti menjëher pas emërimit të tijë do te bëjë edhe inicijimin e zgjedhjeve. Sa i përket kësaj i njeiti së pari ka për të përpiluar listen e votimeve ndaras sipas gjinive. Më pas kësaj i njeiti do të bëjë edhe shpaljen e zgjedhjeve. Shpallja e zgjedhjeve përmban informacione shumë të rëndësishme për votuesit/votueset. Ndër te tjera nga i njeiti është për tu shenuar me atë rast që propozimet për zgjedhje, janë për tu dorzuar me shkrimë tek ai, më së voni një javë para ditës së Mbledhjes së zgjedhjeve për zgjedhjen e Këshillit të ndërmarrjes. Mbledhja e zgjedhjeve për zgjedhjen e Këshillit të ndërmarrjes rrjedhon në të njejtën mënyrë siq edhe u përshkrua më lartë nën pikën 2.1.1. në lidhje me Mbledhjen e dytë të zgjedhjeve për zgjedhjen e Këshillit të ndërmarrjes në procedurën dyfazëshe.

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschek - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.

2.2 Rrjedhimi i procedures normale zgjedhore

Nëse veqse ekzsiton një **Këshill i ndërmarrjes**, atëherë në atë rast i njejt i bënë edhe emërtimin e bordit zgjedhor dhe njëherit përcakton edhe Udhëheqësin e bordit zgjedhor. Në qoftë se Këshilli i ndërmarrjes nuk aktovizohet me atë rast, atëher Këshilli i përgjithshëm i ndërmarrjeve ose Këshilli i ndërmarrjeve të korporatës mund të bëjë emërtimin e të njejtit. Gjitashtu është e mundshme që tre persona me të dejtë vote ose një sindikat pune e cila përfaqsohet në atë ndërmarrje, të parashtrojnë kërkesë pranë Gjykatës së Punës për emërtimin e bordit zgjedhor.

Nëse deri më tani ende nuk ekzsiton një Këshill i ndërmarrjes në atë ndërmarrje pune, atëherë Këshilli i përgjithshëm i ndërmarrjeve ose Këshilli i ndërmarrjeve të korporatës mund të bëjë emërtimin e bordit zgjedhor dhe njëherit edhe të përcaktojnë Udhëheqësin e të njejtit. Nëse emërtimi i tillë nuk realizohet në këtë mënyrë të përshkruar këtu më lartë, atëherë bordi zgjedhor do të zgjedhet nga ana e të gjithë të punësuarve të ndërmarrjes së punës gjatë një Mbledhje të ndërmarrjes, e cila Mbledhje mbahet parimisht në ndërmarrje gjatë orarit të punës. Për në atë Mbledhje mund të ftojnë tre punëmarrës/e me të drejte vote ose një sindikat pune e cila përfaqsohet në atë ndërmarrje të punës. Në qoftë se edhe pse është ftuar me atë rast nuk vjen fare deri tek një Mbledhje e ndërmarrjes ose nëse e njejt nuk zgjedhë një bord zgjedhor, atëherë tre punëmarrës/e me të dejtë vote ose një sindikat pune e cila përfaqsohet në atë ndërmarrje, mund të parashtrojnë kërkesë pranë Gjykatës së Punës për emërtimin e bordit zgjedhor.

Bordi zgjedhor do të pregadit më pas një **fletë votimi**, në të cilen do të radhiten të gjithë punëmarrësit/punëmarrëset ndaras bazuari në gjinin e tyre që kanë. Dokumentacionet e nevojshme në lidhje me këtë bordi zgjedhor do ti pranoj të dorzuar nga Punëdhënësi, bazë kërkesës së parashtruar nga ana e tyre më parë. Më pasë kësaj bordi zgjedhor do të bëjë **shpalljen e zgjedhjeve**. Shpallja e zgjedhjeve përmban shumë informacione të rëndësishme për votuesit/votueset. Vendet minimale për gjinën në pakicë janë për tu marrë në konsideratë.

Kush dëshiron **të kandidojë** për Këshillin e ndërmarrjes, duhet të është radhitur më parë në një listë propozimesh, e cila listë më pasë është për tu dorëzuar brenda dy javësh pranë bordit zgjedhor pas varjes së shpalljes së zgjedhjeve. Lista e propozimeve, e cila njëherit mund të përmbajë një ose më shumë kandidues/e për zgjedhje, duhet të jetë e nënshkruar më parë së paku nga 5 % e të punësuarve me të drejtë vote, ose së paku nga tre të punësuar me të drejte vote (nënshkrimet mbështetëse). Lista/t me propozime e cila/të cilat janë miratuar me atë rast si e/të vlefshme do të varen më pasë me së voni një javë para ditës së zgjedhjeve.

Në qoftë se janë vërtetuar në fakt si të vlefshme dy lista propozimesh, punëmarrësit/punëmarrëset gjate zgjedhjeve mund të vendosin vetëm për njërin prej listave me propozime (**zgjedhja bazë listës**). Nëse është dorzuar vetëm një liste me propozime ose nëse është deklaruar si e vlefshme vetem një listë, atëherë punëmarrësit/punëmarrëset mund të japin votën e tyre kandidatit të vetëm (**zgjedhje bazë personi**). I punësuar mund të plotësoj aq shumë kandidat/e sa edhe ka vende për tu ndarë.

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschek - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.

Ditën e zgjedhjeve do të bëhet zgjedhja e Këshillit të ndërmarrjes në një dhomë të ndërmarrjes së punës gjatë një votimi të drejtëpërdrejtë dhe sekret. Bordi zgjedhor do ti dorëzojë me atë rast secilit punëmarrës/e me të drejtë vote një fletë votimi dhe një zarf të zgjedhjeve. Më

pasë fleta e votimit pas plotësimit të një liste ose të kandiduesve/kandidueseve individuale në listë, do të futet në zarfin e zgjedhjeve dhe hudhet më pastaj në kutin e zgjedhjeve.

Në qofte se punëmarrësit/punëmarreset ditën e zgjedhjeve nuk janë prezent, është për të ju ofruar atyre mundësia për dorëzimin e votës së tyre me shkrimë (votimi me anë të letrës).

Numërimi i votave bëhet në mënyrë publike menjëher pas mbylljes së lokalit të zgjedhjeve. Në rastin e përzgjedhjes së listave, do të bëhet përcaktimi i vendeve të cilat ju janë alokuar me atë rast listave individuale të propozimeve. Të zgjedhur janë ato kandidat/e në renditje siq edhe janë përshkruar në atë listë dhe në atë numër, siq edhe ju takojnë vende asaj liste. Sa i përket përzgjedhjeve të personave janë zgjedhur me atë rast ato kandidat/e të cilët kanë grumbulluar votat e më shumta për vete, por përgjatë së cilës sa i përket numrit të vendeve është gjithmonë për tu marrur në konsiderat gjinia në pakicë. Kandidatët/kandidatet e përzgjedhur/a do të informohen menjëher nga ana e bordit të zgjedhjeve.

3. Mbrojtja zgjedhore dhe shpenzimet e zgjedhjeve

Zgjedhjet e këshillit të ndërmarrjes ju nënshtrohen një mbrojtje të veçantë ligjore. Kushdo që fton në një Mbledhje zgjedhore si njëra/njëri nga tre ftuesit, apo ai i cili parashtron kërkesë në Gjykatën e Punës si njëra/njëri nga tre parashtrueset/parashtruesit e kërkesës për themelimin e një bordi zgjedhor, apo ai i cili është anëtar i bordit zgjedhor dhe ai i cili ka kandiduar për zgjedhjet e Këshillit të ndërmarrjes gëzon një mbrojtje të veçantë e të përkohshme ndaj ndërprerjeve të zakonshme të marrëdhënies së punës.

Ndërprerja e zakonshme e marrëdhënies së punës për njërin prej tre **ftuesve** ose të tre **parashtruesve/parashtrueseve të kërkesës** është e palejueshme me ligjë deri në momentin e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve. Në qoftë se nuk ka ardhur fare deri tek zgjedhjet e Këshillit të ndërmarrjes, atëherë në atë rast nuk është e lejueshme me ligjë të ju ndërpritet atyre marrëdhënia e tyre e punës në mënyrë të zakonshme për një periudh kohore prej tre muajsh duke filluar prej momentit të ftesës, respektivisht prej momentit të parashtrimin të kërkesës pranë Gjykatës së punës. Vetëm një ndërprerje e jashtëzakonshme e marrëdhënies së punës së ftuesve dhe të parashtruesit/parashtrueseve të kërkesës mbetet e mundshme nën rrethana strikte për ndërprerje të jashtëzakonshme të marrëdhënies së punës.

Ndërprerja e zakonshme e marrëdhënies së punës **për anëtarët e bordit zgjedhor** dhe për **kandiduesit/kandidueset për zgjedhje** deri në momentin e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschek - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.

është gjithashtu e palejueshme me ligjë. Mbi të gjitha këto anëtarët e bordit zgjedhor dhe kandiduesit/kandidueset për zgjedhje gëzojnë të drejtë mbrojtjeje në ndërprerje të marrëdhënies së punës me ndikëm të pasëm për një periudh kohore prej gjashtë muajsh nga momentit i shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

Një ndërprerje e jashtëzakonshme e marrëdhënies së punës për anëtarët e bordit zgjedhor dhe për kandiduesit/kandidueset për zgjedhje mbetet i mundshëm nën rrethanat strikte për ndërprerje të jashtëzakonshme të marrëdhënies së punës. Deri në momentin e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve Këshilli i ndërmarrjes duhet të jepë pëlqimin e tijë në lidhje me një ndërprerje të tillë të jashtëzakonshme të marrëdhënies së punës për anëtarët e bordit zgjedhor dhe dhe për kandiduesit/kandidueset për zgjedhje. Punëdhënësi e gezon të drejtën ligjore të parashtrojë kërkesë për zëvendësim të miratimit të mohuar me atë rast.

Punëdhënësi i ka të ndaluar nën kërcnim denimi, të pengojë ose të ndikojë në zgjedhjet e Këshillit të ndërmarrjes. Asnjë punëmarrëse/e nuk guxon të pengohet përgjat ushtrimit të së drejtës së tyre aktive dhe pasive të votimit.

Shpenzimet e procedurës zgjedhore të Këshillit të ndërmarrjes janë për tu bartur nga ana e Punëdhënësit.

➔ Für eine ordnungsgemäße Durchführung der Betriebsratswahl empfehlen wir Ihnen **dringend** den Kauf des Buches: **Tilman Anuschek - "Betriebsratswahl"** (www.riederverlag.de) mit weiterführenden Erläuterungen zu den Formularen.